



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr.326/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesues, Zyhdi Haziri dhe Adnan Konushevi anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjor Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër kandidatit të pavarur për kryetar të Komunës së Shtimes, Ramiz Rexhaj, për shkak të thyerjes së Heshtjes Zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale të 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me 22.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, me të cilën kërkohet që ti shqiptohet dënimi me gjobë ndaj kandidatit të pavarur për kryetar të Komunës së Shtimes, Ramiz Rexhaj, për shkak të thyerjes së Heshtjes Zgjedhore për Zgjedhjet Lokale të 22.10.2017.

A r s y e t i m

Me datën 22.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga BIRN dhe Internews Kosova, me të cilën pretendon se me datë 21.10.2017 kandidatit të pavarur për kryetar të Komunës së Shtimes, Ramiz Rexhaj, ka bërë fushatë duke shpërndarë fotografi në facebook, me përshkrimin “I madh e i vogël për Fatmir Rashiti” duke bërë shkelje të dispozitës së nenit 36.1 pika b) të LZP-së.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur fotografi të printuar lidhur me rastin në fjalë.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën, në kuptim të nenit 117.3 të LZP-së gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës lidhur me shkeljen e pretenduar nga ana e kandidatit të pavarur për kryetar të Komunës së Shtimes, Ramiz Rexhaj, Paneli i vlerësoj se janë të pa qëndrueshme dhe si të tillë e refuzoj ankesën, për faktin se, veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të nenit 36.1 pika b) e LZP-së, për arsye se kandidati i pavarur për kryetar të Komunës së Shtimes, Ramiz Rexhaj nuk mund të vërtetohet se ka bërë bërë thyerjen e heshtjes zgjedhore pasi që nga fotografitë e shpërndara në rrjetin social facebook, nuk mund të identifikohet koha dhe data e shpërndarjes së fotografisë së të njëjtave.

Andaj në mungesë dëshmive të qarta dhe bindëse siç kërkohen me nenin 117 të LZP-së paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Nga arsyet e theksuar më lartë e duke bazuar nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZL. Anr.326/2017 më datën 22.10.2017.

Kryesuesi i Panelit
Gyltene Sylejmani



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.